

ASCAP



SIGURIA NË INTERNET

Manual për mësuesit

Përmbajtja

Hyrje	01
Qëllimi i manualit	02
Interneti dhe shërbimet	03
Rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar fëmijët	05
- Cyberbullying	06
- Përmbajtja e paligjshme dhe e papërshtatshme	08
- Varësia nga interneti dhe kompjuteri	10
- Ngacmimet seksuale	11
- Lojërat online	12
Lundrimi i sigurt në internet	14
Këshilla që mësuesit mund t'i ndajnë me prindërit	15
Sjelljet e duhura gjatë punës online	16
Si dhe ku mund të raportojmë rastet e abuzimit dhe shfrytëzimit online?	20

Hyrje

Ndikimi dhe rritja në mënyrë progresive e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ka prekur çdo aspekt të jetës së përditshme të njeriut, duke filluar nga mënyra e komunikimit me njëri-tjetrin dhe deri te qasjet e ndryshme të ndërveprimit online. Përpos efekteve pozitive të përdorimit të internetit, gjithmonë shfaqen aspekte negative lidhur me përdorimin e tij. Raportet ndërkombëtare tregojnë se gjithmonë e më shumë duhet t'i kushtohet një rëndësi e veçantë hartimit dhe integritit të politikave arsimore, të cilat përfshijnë edukimin e nxënësve dhe mësuesve lidhur me sigurinë kibernetike dhe rreziqet që vijnë nga përdorimi i internetit.

Me zhvillimin e hovshëm të teknologjisë vërehet edhe rritja e dukshme e qasjes së fëmijëve në internet, përfshirë ata të moshave shumë të reja. Krahas rritjes së vazhdueshme të numrit të fëmijëve që përdorin internetin nëpërmjet pajisjeve të ndryshme elektronike, rriten edhe mundësitë për të mësuar gjëra të reja në internet, por njëkohësisht rritet edhe ekspozimi i fëmijëve ndaj rreziqeve të ndryshme. Padyshim se përdorimi i kujdesshëm i internetit ndihmon fëmijët të mësojnë më shumë për botën dhe mund të shërbejë si një mjet i dobishëm për zhvillimin e tyre akademik e personal. Mirëpo, nëse nuk përdoret në mënyrë të kujdesshme dhe pa mbikëqyrje nga të rriturit, qasja e fëmijëve në internet mund të rezultojë e dëmshme dhe paraqet rreziqe serioze.

Rreziku i abuzimit të fëmijëve në internet për shkak të mungesës së kontrollit nga prindërit apo mësuesit e tyre është një problematikë, e cila kërkon zgjidhje të menjëhershme. Inkurajimi i përdorimit të sigurt dhe të përgjegjshëm të internetit si dhe njohuritë mbi rreziqet potenciale janë hapa të rëndësishëm drejt ndërtimit të një platforme të menaxhimit të rrezikut për të mbajtur fëmijët të sigurt në internet.

Qëllimi i manualit

Fusha e mbrojtjes së nxënësve në internet përfshin një gamë të gjerë rreziqesh që kërcënojnë sigurinë dhe mirëqenien e tyre. Është një sfidë komplekse që duhet trajtuar nga këndvështrime të shumta, përfshirë legjislacionin, qeverisjen, arsimin, politikat dhe shoqërinë. Për më tepër, mbrojtja e fëmijëve në internet duhet të bazohet në të kuptuarit e rreziqeve, kërcënimeve dhe dëmeve të përgjithshme e specifike në mjediset digjitale. Kjo kërkon përkufizime të qarta dhe vendosjen e parametrave të duhur për ndërhyrjen që përfshin dhe bën dallimin midis akteve që përbëjnë një krim dhe atyre që megjithëse nuk janë të paligjshme, paraqesin një kërcënim për mirëqenien e një fëmije.

Interneti është një mjet komunikimi e argëtimi i përdorur në mbarë botën. Interneti tashmë nuk është më një risi për fëmijët dhe të rinjtë, por një nevojë e domosdoshme për ata. Të gjithë fëmijët kanë një sërë të drejtash që duhet të respektohen, edhe në internet. Ata kanë të drejtën për të mos u shqetësuar, ofenduar apo ngacmuar nga përdoruesit e tjerë. Ata kanë të drejtë të komunikojnë dhe gjithashtu të argëtohen. Në anën tjetër, fëmijët kanë të drejtë të marrin informacione me përmbajtje të përshtatshme për moshën e tyre. Zhvillimet teknologjike kanë gjeneruar mundësi të reja që përfshijnë të drejtën për të prodhuar informacion, për të shprehur veten e tyre dhe për të gjeneruar ide. Tani nxënësit janë protagonistë të internetit, dhe jo vetëm konsumatorë pasivë. Zhvillimi i vrullshëm i teknologjisë në vitet e fundit shoqërohet njëkohësisht edhe me ekspozimin e fëmijëve ndaj risqeve si rrjedhojë e lundrimit jo të sigurt në internet, prandaj duhet të merren masa për sigurinë e tyre. Në këtë kontekst, është hartuar ky udhëzues për të ndihmuar mësuesit të njohin sfidat dhe rreziqet e botës virtuale dhe për të kontribuar në promovimin e internetit sa më të sigurt për nxënësit. Udhëzuesi shërben si një material ndihmës për mësuesit, i cili ka për qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e mësuesve për sigurinë në internet.

Interneti dhe shërbimet

Interneti revolucionizoi kompjuterat dhe botën e komunikimit si asnjëherë tjetër më parë. Interneti ka filluar të zhvillohet në fund të viteve 1960 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga një grup studiuesish amerikanë, fillimisht për nevoja ushtarake. Interneti është një sistem global i rrjetave të ndërlidhura kompjuterike të cilat bëjnë shkëmbimin elektronik të të dhënave (tekst, muzikë video, fotografi, etj) nëpërmjet përdorimit të kablove, fibrave optike, lidhjeve pa tela dhe teknologjive të tjera. Këto informacione mund të lexohen, shikohen apo shkarkohen nga përdorues të ndryshëm.


Për ta kuptuar më lehtë se si funksionon interneti, ne po marrim një shembull të thjeshtë për ilustrim.

Supozojmë që në shkollën tuaj ka dy kompjutera, të cilët janë të lidhur midis tyre përmes një modemi, i cili iu mundëson kompjuterave të shkëmbejnë informacione. Tani nëse supozojmë që një lidhje të ngjashme ka edhe në shkollë të tjera dhe nëse të gjitha këto mini-rrjete brenda shkollave lidhen së bashku në një rrjet të vetëm formojnë atë që e quajmë internet. Me fjalë të tjera, interneti është një mënyrë e dërgimit të informacionit nga një kompjuter në një tjetër kudo në botë dhe paraqet një sistem global të rrjeteve të ndërlidhura kompjuterike të disa miliarda pajisjeve në botë.



Kjo lidhje në rrjet ofron mundësi të mirë të shfrytëzimit të informacioneve të ngarkuara në internet për punë, edukim, komunikim e jetë shoqërore. Duke përdorur internetin, fëmijët janë në gjendje të udhëtojnë nëpër botë pa pasur nevojë të dalin nga dhoma e tyre (p.sh. përmes Google earth), të vazhdojnë të mësojnë pas përfundimit të orëve të mësimin në shkollë, të komunikojnë me njëri-tjetrin dhe të krijojnë produkte të ndryshme në internet, të cilat mund të shikohen nga e gjithë bota (p.sh. web-faqe personale, blogs, fotografi, etj)

Në internet mund të kyçet çdokush nëse ka një kompjuter apo pajisje të ngjashme elektronike, e cila është e lidhur në internet dhe ka një llogari me një ofrues të shërbimit të internetit. Interneti është i projektuar për të vepruar nga shumë vende të ndryshme. Asnjë organizatë apo individ në botë nuk është pronar i internetit, por secili shtet nxjerr ligje në lidhje me përdorimin ose përmbajtjen e tij. Pasi të jeni lidhur në internet, ju mund të hyni në një shumëllojshmëri të aktiviteteve të quajtura shërbimet e internetit. Numri i shërbimeve të ofruara në internet është rritur në mënyrë të vazhdueshme me avancimin e teknologjisë. Shërbimet më të popullarizuara në internet që aktualisht përdoren janë:



Shfletimi i faqeve të internetit (webBrowsing)

Realizohet duke përdorur një program të veçantë për shfletim, siç janë: Internet Explorer, Safari, Firefox, Opera, Google Chrome etj. për të kërkuar dhe shikuar faqe të internetit, të cilat mund të kenë tekst, fotografi, muzikë, video, lojëra, etj.



E-mail

E-mail - është një shërbim që ju lejon të dërgoni mesazhe të shkruara, muzikë, video etj. tek një person tjetër nëpërmjet internetit. Me ndihmën e postës elektronike bëhet e mundur shpërndarja e mesazheve digjitale nga dërguesi te marrësi.



Chats

Chat - përdoret për të dërguar mesazhe të menjëhershme për njerëzit e tjerë që janë të kyçur në "chat", duke krijuar një bisedë virtuale. Këto biseda mund të bëhen me miqtë apo me të panjohurit. Dhomat e chatit janë vende virtuale të takimit ku njerëzit komunikojnë dhe dërgojnë mesazhe me njëri-tjetrin.



Forumet

Forumet - janë hapësira virtuale në internet ku njerëzit mund të postojnë mesazhe në lidhje me një temë të caktuar. Njerëzit me interesa të ngjashme mund të lexojnë mesazhet dhe postojnë komente të ndryshme.



Mediat sociale

Mediat sociale janë kanale digjitale interaktive që lehtësojnë krijimin dhe ndarjen e informacionit, ideve, interesave dhe formave të tjera të shprehjes përmes komuniteteve dhe rrjeteve virtuale. Ato ofrojnë një shumëllojshmëri të shërbimeve të pavarura dhe të integruara.

Rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar fëmijët

Duke pasur parasysh numrin e lartë të përdoruesëve të internetit, atëherë duhet të kuptojmë që edhe numri i keqdashësëve është i lartë. Kërkime të ndryshme kanë treguar se fëmijët që e përdorin internetin, kanë mundësi që të mësojnë më shumë dhe të ekspozohen më shumë ndaj rreziqeve. Megjithatë, fëmijët nuk mund të kufizohen nga përdorimi i internetit, sepse në ditët e sotme përdorimi i internetit është një pjesë natyrore e zhvillimit të tyre. Sipas një studimi të bërë nga organizata World Vision në vitin 2014, rreziqet më kryesore të perceptuara nga fëmijët janë të lidhura me përmbajtjen, pasuar nga ato lidhen me sjelljen dhe më pas ato që lidhen me kontaktet e papërshtatshme. Fëmijët duhet të kuptojnë se duhet t'u përmbahen disa rregullave në mënyrë që të jenë më të sigurt kur janë online. Prandaj, siguria në internet është shumë e rëndësishme dhe ne duhet t'i mësojmë që të mbrohen nga keqbërësit kur përdorin internetin.

Normalisht, edhe pse ka rreziqe, interneti nuk duhet të jetë një vend i rrezikshëm për fëmijët. Përdorimi i internetit është një burim i madh për t'i ndihmuar ata në përgatitjen e detyrave të shtëpisë. Fëmijët e përdorin internetin për të luajtur lojëra, për të shprehur kreativitetin e tyre ose për të vizituar sajtet e tyre të preferuara. Duke qenë të vetëdijshëm për kërcënimet që mund t'u ndodhin fëmijëve në internet, mësuesit duhet të njohin të gjitha rreziqet që vijnë nga përdorimi i internetit dhe të marrin masat përkatëse për t'i shmangur këto rreziqe. Në vijim do japim një përshkrim të rreziqeve më të larta me të cilat fëmijët mund të përballen në internet dhe çfarë duhet të bëjnë ata për t'u mbrojtur nga këto rreziqe.

Cyberbullying

"Cyberbullying" është rasti i bullizmit kur një fëmijë apo adoleshent është kërcënuar, keqtrajtuar, poshtëruar, tallur, ofenduar ose është vënë në shënjestër në mënyrë të qëllimshme nga një fëmijë ose adoleshent tjetër duke shfrytëzuar përdorimin e internetit, teknologjitë interaktive dhe digjitale ose telefonat celularë. Bullizmi kibernetik është një formë e veçantë e bullizmit që mund t'i bashkohet formave të tjera të bullizmit duke përdorur internetin. Teknologjia digjitale përfshin: email-et, celularët, chat, faqe të rrjeteve sociale dhe mesazhe në mënyrë të vazhdueshme. Këto mund të përdoren të gjitha për të ushtruar bullizëm ndaj të tjerëve verbalisht, psikologjikisht apo nga rrjetet sociale.

Dërgimi i e-mailave që mund të jenë kërcënues apo shqetësues (psh. mesazhe fyese, raciste apo paragjykime të tjera).

Dërgimi ose postimi i thashethemeve të shokët apo direkt të viktimës.

Postimet në rrjetet sociale — psh. shpërndarja e sekreteve të dikujt në rrjetet sociale (p.sh. Facebook, Instagram ose Twitter).

Fyerja e fëmijëve duke iu vënë etiketime apo pseudonime përmes mesazheve, komunikimit në Chat, postimit në Facebook, etj.

Dërgimi ose postimi i fotografive të personave të tjerë, pa lejen e tyre (zakonisht fotografi intime/personale) në internet.

Krijimi i profileve apo web-faqeve të caktuara në internet, duke shënjestruar një individ apo grup të caktuar fëmijësh me qëllim talljeje apo fyërjeje

Fëmijët përdorin metoda të ndryshme për të ushtruar cyberbullying , mirëpo më të shpeshtat janë mesazhet nëpërmjet telefonave mobile, e-mail, chat-it, fotografi, webfaqet të dedikuara ndaj dikujt për të shënjestruar një individ apo grup të caktuar fëmijësh. Është me rëndësi që nëse keni pranuar mesazhe me përmbajtje fyese apo kërcënuese, asnjëherë të mos ju përgjigjeni, e vetmja gjë që duhet të veproni është të injoroni mesazhin. Preferohet që mesazhet e tilla të ruhen si dëshmi për raportim. Në këto raste duhet patjetër të siguroheni që të njoftoheni nga nxënësit tuaj, në mënyrë që të gjeni një mundësi për t'i ndihmuar. Gjithmonë respektoni njerëzit e tjerë dhe jeni të vetëdijshëm për atë që pranoi dhe dërgoni gjatë kohës që ju jeni në internet.

Metodat dhe teknologjitë e përdorura

- Telefonatat, mesazhet përmes telefonit;
- E-mailat apo mesazhet e çastit ;
- Fotografitë digjitale (nga aparatet digjitale dhe telefonat mobile);
- Dhomat e chat-it, dhomat e diskutimit dhe grupet e ndryshme të chat-it në internet;
- Webfaqet e dedikuara ndaj dikujt për të shënjestruar një individ apo grup të caktuar fëmijësh;
- Përdorimi i formueve apo mediave sociale për të shpërndarë imazhe apo informacione private.

Përse fëmijët ngacmojnë njëri-tjetrin?

Shpesh fëmijët ngacmojnë të nxitur nga zemërimi, hakmarrja, inati ose pasiguria. Ndonjëherë ngacmimi mund të ndodhë edhe për qëllime zbavitjeje por në këto raste është e vështirë të përcaktohet toni i dërguesit. Ndodh që ngacmimi midis fëmijëve të nisë si një lojë e më pas të zhvillohet dhe të përshkallëzohet në ofendime. Shakaja e një personi mund të jetë ofendim i rëndë për një person tjetër.

Këshilloni nxënësit që:

- Të mos iu përgjigjen mesazheve me përmbajtje fyese;
- Të ruajnë orën dhe datën e mesazhit të marrë si dëshmi në rast raportimi, *këshillojini të ruajnë print screen-et, e-maillet dhe tekstet e mesazheve;*
- Të bllokojnë aksesin e atyre personave me të cilët nuk kanë dëshirë të komunikojnë;
- Nëse nxënësit kanë pranuar mesazhe me përmbajtje fyese apo kërcënuese, t'u tregojnë prindërve apo kujdestarëve të tyre;
- Të bisedojnë me ju apo me një të rritur, familjar, të afërm për ngacmimet që nxënësit kanë pasur;
- Të identifikojnë personin i cili është shkaktari i ngacmimit online;
- Të raportojnë rastet e cyberbulling në faqen www.isigurt.al ;
- Të vizitojnë faqen www.isigurt.al për t'u informuar për mënyrat se si mund ta mbrojnë veten gjatë aktivitetit online;
- Të telefonojnë ALO 116 111 –Linja Kombëtare e Këshillimit .

Përmbajtja e paligjshme dhe e papërshtatshme

Interneti ofron burime të ndryshme informacioni dhe argëtimi. Burimet janë nga ato më të besueshmet, të licensuarat deri te faqe pirate të palicensuara. Jo të gjitha përmbajtjet që janë në internet janë të përshtatshme për të gjitha moshat. Disa faqe nuk rekomandohen të shikohen nga fëmijët e moshave nën 18 vjeç. Kjo për arsye se fëmijët e kësaj moshe ende nuk janë të gatshëm për të parë këto informacione, pasi në të kundërt mund të ndikojë negativisht në zhvillimin e tyre. Lehtësia për të lexuar këto përmbajtje tregon se fëmijët janë të ekspozuar ndaj risqeve. Në këtë pjesë do të shpjegojmë cilat janë rreziqet që u kanosen fëmijëve dhe të rinjve gjatë qëndrimit online. Çfarë dëmsh krijon marrja e informacionit pornografik në një moshë të hershme?

Shfletimi i faqeve në internet në përgjithësi është i pakufizuar. Fëmijët inkurajohen që të kenë një qasje sa më të sigurt në internet në mënyrë që të menaxhojnë rrezikun kur janë online. Aksesit i faqeve jo të sigurta dhe shkarkimi i materialeve jo të përshtatshme për moshat e reja mund të rezultoi edhe me viruse të ndryshme. Fëmijët duhet të njihen me rreziqet potenciale që mund të paraqiten nga shikimi i pamjeve apo përmbajtjeve të dëmshme, shqetësuese dhe ilegale. Fëmijët, por edhe të rriturit, ekspozohen për shkak të sulmeve 'spam' apo viruseve të ndryshme. Prandaj fëmijët duhet të pajisen me njohuri të nevojshme për t'u mbrojtur dhe për të shfletuar të sigurt në internet.

Përmbajtja e papërshtatshme është një përkufizim, i cili i referohet çdo lloj përmbajtjeje në internet; verbale, vizuale, audio dhe video, e cila është e rrezikshme dhe e papërshtatshme për moshën e fëmijëve, por është në dispozicion. Për shkak të hapësirës së madhe të shtrirjes së internetit kemi të bëjmë me një larmi të madhe të interesave të subjekteve të ndryshme.

Pasojat nga shikimi i pamjeve të papërshtatshme për fëmijë janë të shumta, por më të rëndësishmet ndikojnë në: shëndetin emocional dhe mendor të fëmijëve;

- promovojnë "mungesë të edukimit" seksual;
- është një falsifikues për dashuri erotike dhe intimitetin;
- ndikon negativisht te zhvillimi psikologjik dhe mendor i fëmijës;
- nxit dhe provokon dëshira seksuale;
- provokon sjellje të papërshtatshme seksuale;
- keqeducim për çështjet e seksualitetit;

Këshilla për nxënësit:

- Përpiquni të respektoni kufizimet e moshës;
- Kuptoni që jo çdo informacion që mund të gjendet në internet është i besueshëm;
- Kuptoni që materialet që nuk janë të dedikuara për ju, nuk duhet të shikohen;
- Mos jepni të dhëna personale;
- Bisedoni me prindërit për të identifikuar bashkërisht faqet dhe burimet serioze të informacionit;
- Mos shkarkoni dhe dërgoni foto dhe video me përmbajtje të papërshtatshme;

Varësia nga interneti dhe kompjuteri

Koha e kaluar në internet shpesh mund të jetë jashtëzakonisht produktive. Ka raste kur përdorimi i pakontrolluar i internetit mund të ndikojë negativisht në jetën e përditshme, në punë, dhe aspekte të tjera të jetës shoqërore. Dëshira e tepërt apo pasioni në rritje i fëmijëve për të qëndruar pranë kompjuterit apo telefonave mobile, shumë shpejt mund të kthehet në një varësi të përdorimit të internetit. Varësia nga interneti është një term që përdoret për të shpjeguar përdorimin e tepruar të internetit nga përdoruesit e tij dhe përfshin një mori të problematikave të tilla si:

Shpenzojnë periudha të gjata kohore në internet dhe nuk menaxhojnë dot kohën në mënyrë produktive.

Preferojnë të komunikojnë më shokët e tyre më shumë virtualisht, sesa fizikisht.

Nuk kanë kohë të mjaftueshme për të përgatitur detyrat e shtëpisë.

Ndikim negativ në marrëdhëniet familjare, prishje e raporteve me shoqërinë.


Preferojnë të luajnë për orë të gjata në lojërat online se sa lojërat reale.

Humbje e interesit në aktivitetet fizike.

Probleme me shëndetin (pagjumësi, lodhje fizike, regjim i keq ushqimor).

Ngacmimet seksuale

Në fokus të veçantë do të përmendim ngacmimin seksual, i cili është një nga format e dhunës me të cilën fëmijët mund të përballen online. Ngacmimi seksual kuptohet si angazhim për veprime të natyrës seksuale të cilat cenojnë dinjitetin e një personi me çdo lloj forme apo mjete, duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues apo fytes. Nëse dhuna e drejtpërdrejtë mund të ndodhë në ambiente të caktuara, ngacmimi digjital mund të ndodhë kudo, në çdo kohë, në çdo hapësirë ku dhuna seksuale ka akses. Duke marrë parasysh rritjen e numrit të përdoruesve të Internetit, kuptojmë që rritet edhe shtrirja e ngacmimit seksual në mjediset virtuale. Sot është bërë gjithnjë e më i vështirë kontrolli i përmbajtjeve apo mesazheve që dërgohen në Internet. Si ndodh ky fenomen, si kontaktohen fëmijët nga të panjohurit? Njerëzit që kanë tendencë të ngacmojnë, shpesh janë anonimë ose krijojnë profile të pavërteta, duke fshehur identitetin e tyre të vërtetë. Por mund të ndodhë që të jenë dhe moshatarë të cilët kanë dëshirë të ngacmojnë miqtë e tyre. Po ashtu, objekt sulmi mund të jenë edhe mësuesit, ndaj duhet bërë shumë kujdes gjatë kohës së punës online. Nëse përballen me çdo lloj forme të dhunës në internet, qoftë ky ngacmimi seksual, dhuna psikologjike etj., atëherë nxënësit kanë të drejtë të kërkojnë ndihmën e policisë. Duke u bazuar në "Dokumentin e Politikave për Sigurinë Kibernetike 2015 – 2017" policia ka një rol kryesor në trajtimin e rasteve të krimit kibernetik. Në disa raste të këtyre ngacmimeve, mund t'u kërkohej oficerëve të policisë të vizitojnë shkollat, t'u përshkruajnë nxënësve natyrën serioze të kësaj sjelljeje, rolin e tyre në mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi online dhe disa nga pasojat e mundshme për ngacmuesin dhe viktimën.



Lojërat online

Interneti sot mundëson faqe të ndryshme të cilat ofrojnë argëtim nëpërmjet lojërave të tyre kompjuterike. Ju mund të luani me kompjuter, telefona celularë, në rrjete sociale etj. Nëse luani lojëra në internet, jeni të ekspozuar ndaj disa rreziqeve:

- Ka persona të rritur, që përfshihen në lojë bashkë me nxënësit. Ata shpeshherë shtiren sikur janë fëmijë për të krijuar shoqëri, por qëllimi i tyre nuk është pozitiv. Ata mund të duan të fitojnë besimin e tyre me qëllim manipulimin e tyre.
- Gjatë lojës shpeshherë shfaqen në ekranin e nxënësve pop-ups (faqe interneti të cilat dalin si rekomandime) përgjithësisht janë reklama, por mund të këtë edhe faqe me përmbajtje të papërshtatshme. Hapja e tyre automatikisht rrezikon kompjuterin që po përdorni duke qenë se ato mund të jenë burim virusesh, të cilat dëmtojnë gjendjen e tij.

Çfarë duhet të bëjnë nxënësit përgjatë lojrave online ?

- Të përdorin pseudonime gjatë lojës, në mënyrë që të mos zbulohet identiteti i tyre.
- Të mos shpërndajnë informacionet e tyre personale (identitetin, adresën, numrin e telefonit, foto personale etj) me njerëz të panjohur;
- Rekomandohet të pyesin prindërit para se të fillojnë të luajnë ndonjë lojë të re.
- Të marrin miratimin e prindërve paraprakisht. Ata i ndihmojnë të zgjedhin lojërat më të sigurta;
- Të informohen për varësinë psikologjike që mund të krijojë përdorimi i tepërt i lojërave;
- Të mos lejojnë veten të bëhen të varur pas lojërave në internet;
- Të mbrojnë llogarinë e tyre kur i krijojnë duke vendosur një fjalëkalim të fortë. Fjalëkalimet (password) e forta kanë së paku tetë karaktere dhe përfshijnë një kombinim të shkronjave të mëdha, numrave, shkronjave të vogla dhe simboleve;



Disa nga pasojat negative kur krijojmë varësi ndaj lojërave online

<i>Pasoja emocionale</i>	<ul style="list-style-type: none">• Nevoja për të kaluar gjithnjë e më shumë kohë në Internet ose për të luajtur me video-lojëra .• Ndjenja sikur i mungon diçka gjatë kohës kur nxënësi nuk është i lidhur online.• Rritja e ndjenjës së antkhit dhe shenja depresioni.• Rritja e nervozitetit kur dikush i pengon të luajnë ose iu ndërpret lojën
<i>Pasoja fizike</i>	<ul style="list-style-type: none">• Pagjumësi ose gjumë i çrregullt për shkak të lodhjes.• Mungesa e oreksit ose kequshqyerje.• Humbje ose shtim i pakontrolluar në peshë.• Dhimbje koke të vazhdueshme.• Dhimbje sysh, dhimbje shpine.• Marrje mendsh, të vjella.
<i>Pasoja relacionale</i>	<ul style="list-style-type: none">• Mbyllja në vetvete• Konflikte me të afërmit kur ata mundohen të kufizojnë sjelljen online ose të ndalojnë përdorimin e këtyre mediave.• Gënjeshtria nga ana e përdoruesit për të fshehur aktivitetin e tij online.• Lënia pas dore e aktivitete të tjera argëtuese.• Vënia në vështirësi e marrëdhënieve familjare dhe shoqërore.
<i>Pasoja profesionale</i>	<ul style="list-style-type: none">• Vështirësi shkollore (ulja e performancës akademike, mungesa të vazhdueshme që mund të çojnë deri në ngeljen në klasë).

Lundrim i sigurt në internet



Si të mbroni kompjuterin tuaj?


Mbajini të gjitha programet kompjuterike (duke përfshirë edhe browser-in tuaj) në përditësim automatik. Përdorni firewall, antivirus, antispam, antispyware, apo software të tjera për mbrojtjen e lundrimit tuaj në rrjet. Vendosni fjalëkalime për të mbrojtur lidhjen tuaj wireless në shtëpi.



Mbroni të dhënat tuaja personale



Përpara se të vendosni të dhënat tuaja, shikoni për shenja të sigurisë që një web faqe mund të ketë; Web https ("s", e siguar) dhe një dryn të mbyllur () afërndenjës. Asnjëherë mos jepni të dhënat tuaja në përgjigje të një e-maili, apo sms-je.



Mendoni përpara se të klikoni

Mendoni përpara se të bashkëngjitni skedarë a foto, apo të klikoni mbi një link në një e-mail; në qoftë se ju nuk i njihni dërguesit, ata mund të jenë të rremë. Jini të kujdesshëm kur klikoni linqe të ndryshme në internet.

Krijoni fjalëkalim të fortë dhe mbajeni atë të fshehtë



Krijoni fjalëkalim me të paktën tetë karaktere dhe përfshini në të gërma të mëdha dhe të vogla, numra dhe simbole. Mos përdorni të njëjtin fjalëkalim kudo.




Mbroni veten nga mashtrimet në e-mail

Mendoni përpara se të bashkëngjitni skedarë a foto, apo të klikoni mbi një link në një e-mail; në qoftë se ju nuk i njihni dërguesit, ata mund të jenë të rremë. Jini të kujdesshëm kur klikoni link-e të ndryshme në internet.

Këshilla që mësuesit mund t'i ndajnë me prindërit:


Si t'i mbrojmë nxënësit gjatë kohës së punës online

Rregulli nr.1




Fëmijët duhet të dinë në cilat kushte, në cilën periudhë dhe në cilën mënyrë mund ta përdorin internetin. Këto kushte i përcaktoni ju. Filloni, për shembull, me kushtin se internetin mund ta përdorin vetëm pasi të kenë përfunduar detyrimet shkollore.

Rregulli nr.2



Vendoseni kompjuterin në vend qendror, në dhomë apo në klasë, që të mund të shikoni kohë pas kohe se ç'bëjnë fëmijët tuaj. Kjo është e rëndësishme që të vëreni në qoftë se fëmijët rastësisht hasin në përmbajtje të cilat nuk korrespondojnë me moshën dhe interesat e tyre.

Rregulli nr.3



Fëmijëve nuk duhet t'u lejoni të kalojnë më shumë se 1-2 orë në ditë para monitorit të kompjuterit. Për fëmijët deri në moshë 7-vjeçare, më mirë është të shfletoni së bashku me ta, ndërsa për fëmijët më të rritur, është e rëndësishme të përcaktoni ku mund të hyjnë dhe ku nuk mund të hyjnë në internet, para se të fillojnë me aktivitetet online (për të bllokuar disa faqe gjeni informacion në kapitullin në vijim të dokumentit).



Është e rëndësishme që nxënësit të ndërgjegjësohen edhe për përdorimin e sigurt të celularit. Ne duhet t'u transmetojmë disa rregulla që mund t'u vijnë në ndihmë për të përdorur siç duhet çdo pajisje që lidhet me Internetin. Pajisjet si telefonat celularë, tabletët, laptopët, mund të kenë akses në internet, të bëjnë fotografi apo të regjistrojnë tinguj, ndaj bëni kujdes kur përdorni wi-fi në ambiente publike, pasi persona të panjohur mund të marrin informacione nga telefoni juaj.

Sjelljet e duhura gjatë punës online



Ruajtja e të dhënave personale.

Gjatë kohës që në klasë shpjegoni Internetin, duhet të ndërgjegjësoni nxënësit që ata nuk duhet t'ua japin të dhënat e veta personale njerëzve të panjohur në internet. Të përdorin gjithnjë opsionet për të ruajtur privatësinë e tyre. Informacionet që ata japin duhet t'i transmetohen vetëm një rrjeti të ngushtë shokësh. Duhet të kuptojnë që çdo gjë që hidhet në Internet mbetet aty, madje edhe kur e fshijnë atë, në disa raste mbeten gjurmë të informacionit që kanë dhënë. Çdokush duhet të ndërgjegjësohet që është e padrejtë që të zbulojmë të dhëna dhe informacione për shokët apo familjarët. Një kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet publikimit të fotove, pasi disa njerëz mund t'i marrin dhe t'i manipulojnë ato.



Takimi i drejtpërdrejtë.

Mësoni fëmijët që në jetën reale të mos takohen me personat, të cilët i kanë njohur online. Nëse ndodh që nxënësit të takohen me njerëzit që kanë njohur online, ata duhet të jenë gjithnjë të shoqëruar nga një i rritur. Takimi duhet të realizohet në një vend publik, që të ketë ndriçim dhe të ketë njerëz. Adoleshentët të cilët do të takohen me një të rritur, duhet të marrin me vete një shok të vetin apo dikë që mund t'i vinte në ndihmë në rast rreziku.



Mësoni nxënësit të publikojnë përmbajtje me përgjegjësi.

Para se të vendosim të shpallim një informacion, është e rëndësishme të njohim mirë serverin në të cilin do të publikohet informacioni. Nëse në servera të caktuara ju hasni informacione të papërshtatshme me moshën e nxënësve, është e rëndësishme që të vini në dijeni edhe mësuesit e tjerë. Ka servera që mundësojnë, që në video të caktuara të vendosen opsione që mos të hapen nga fëmijë të një moshe të caktuar. Një shërbim i tillë ofrohet nga YouTube, i cili mundëson vendosje të flamujve në video të papërshtatshme, që më vonë ato të fshihen.



Përdorimi i programeve dhe aplikacioneve të kontrollit

Një nga masat për të ofruar siguri për fëmijët në internet është përdorimi i softwerëve specialë për filtrimin e informacionit, mbikqyrja e vazhdueshme e punës së tyre në internet dhe kontrolli i vazhdueshëm nga prindërit, siç është dhe përshtatja e opsioneve të gatshme për siguri të sajteve që ata përdorin.

Është e rëndësishme që në kabinetin e informatikës të gjendet një rregullore, rreth formave se si të jemi të sigurt gjatë punës në kompjuter!

- Që nxënësit të jenë të sigurt duhet që çdo kompjuter të jetë i pajisur me një skanues të mirë për viruse.
- Mos hapni asnjëherë faqe që ofrojnë çmime që janë tunduese për të qenë të vërteta.
- Kur hapni adresën e e-mailit në kompjuterin e shkollës ose në qendrat e internetit, sigurohuni që kur të mbaroni punë ta mbyllni dhe mos të regjistroni passwordin në kompjuter.
- Mos ruani dokumente, të cilat ju do t'ia tregonit vetëm mikut tuaj më të mirë.
- Tregoni shumë kujdes nga e-mailet që thonë 'përcillja këtë të gjithëve'. Këto lloj e-mailësh përmbajnë rrengje dhe mashtrime.
- Mos hyni në asnjë website bankar që pretendon se keni nevojë për të rinovuar ose konfirmuar fjalëkalimin tuaj.
- Mbaj gjithmonë sekret fjalëkalimin.
- Trego kujdes kur shkarkon skedarë falas dhe lojëra nga interneti ose nëpërmjet postës elektronike; ato mund të përmbajnë një virus apo mund t'ju dërgojnë në një website të papërshtatshëm.
- Ndonjëherë njerëzit mund t'ju mashtrojnë me një link që do t'ju dërgonte në vende të pakëndshme në internet.

Programe të filtrimit dhe kontrollit

Përveç kontrollit nga ana e kompanive të cilat furnizojnë shkollat me internet, disa programe të thjeshta mund të përdoren dhe nga mësuesit për të siguruar më tepër kompjuterat me të cilët punojnë nxënësit në shkollë. Filtri i webit, i cili zakonisht quhet "softuer i kontrollit të përmbajtjes", është një pjesë softuerike e krijuar për të kufizuar faqet e internetit që një përdorues mund të vizitojë në kompjuterin e tij ose të saj. Këta filtra mund të funksionojnë duke përdorur një listë të paracaktuar për të lejuar aksesin vetëm në sajtet e zgjedhura në mënyrë specifike.

Microsoft Security Essentials është një antivirus FALAS që ofrohet nga Microsoft për çdo përdorues të sistemeve operative Windows Genuine.

- a) Ju mbron nga Viruset, Trojanet, Worms dhe Spyware;
- b) Për shkak se është falas nuk kërkon regjistrim apo deklaram të të dhënave personale;
- c) Mbrojtje e sigurt në background. Ju shikoni alarmet vetëm në rast kur kapet virus apo vizitoni një site të pasigurt.

Aktivite për nxënësit

Nxënësit do të familjarizohen me dy rregulla bazë për kërkimin e informacionit në internet. Njohuritë që do të zhvillojnë nxënësit:

- mësojnë të kufizojnë kërkimet e tyre.
- fillojnë të dallojnë faqet e dobishme të internetit.
- zgjedhin faqe interneti strategjike si rezultat i motorëve të kërkimit.



Kohëzgjatja: 45 minuta

Zhvillimi i kompetencës digjitale, me qëllim rritjen e sigurisë gjatë punës online.

Gjetja e informacionit të sigurt dhe zhvillimi i aftësisë kritike.

Nxënësit mësojnë të bisedojnë rreth informacioneve që iu duhen dhe se si mund ta gjejnë e ta përdorin atë (p.sh. duke kërkuar në internet ose CD-ROM, duke përdorur materialet e printuara, duke pyetur njerëzit etj.)

Nxënësit duhet të mësojnë si të përgatisin informacionin për zhvillimin e përdorimit të TIK-ut, duke përfshirë përzgjedhjen e burimeve të përshtatshme, duke gjetur informacion, duke e klasifikuar dhe e kontrolluar atë për saktësi (p.sh. gjetjen e informacionit nga librat apo gazetat), duke krijuar një databazë të klasës, duke klasifikuar në bazë të karakteristikave dhe qëllimeve, duke kontrolluar përputhjen e drejtshkrimin të fjalëve.

Nxënësit duhet të zotërojnë aftësitë bazë për të menduarit kritik që të kërkojnë, vlerësojnë, përdorin dhe krijojnë informacion për të përmbushur synimet e tyre personale, shoqërore, profesionale dhe arsimore.

Nxënësit duhet të jenë të aftë të përcaktojnë tipin e informacionit të nevojshëm për një detyrë të caktuar dhe të sigurojnë informacionin në mënyrë cilësore dhe të efektshme.

Përshkrimi i mësimit



Kohëzgjatja: 45 minuta

Aktiviteti	Nxënësit duhet të aftësohen për të kërkuar informacion në mënyrë të sigurtë	Koha
Aktiviteti 1	Prezantoni një aktivitet duke e ngushtuar kërkimin dhe punoni në grup për ta plotësuar aktivitetin.	10 minuta
Aktiviteti 2	Përdorimi i motorëve të kërkimit dhe faqeve të besueshme të internetit për të përzgjedhur faqet më të dobishme.	15 minuta
Realizimi i aktiviteti	Nxënësit rikthehen në zgjedhjet e tyre të faqeve më të dobishme të internetit dhe prezantojnë detyrat e shtëpisë për të hartuar një poster kërkimi të sigurtë.	15 minuta
Zgjerim njohurish	Ç'kuptim kanë shkronjat në fund të adresës së faqes së internetit?	5 minuta

Mundësitë për vlerësim.

Vlerësimet do të bëhen duke u bazuar te projektet dhe te përgjigjet gjatë mësimit. Përveç kësaj, mësuesit mund të marrin në konsideratë edhe krijimin e një faqeje të re (mund të jetë dokument në Word ose Power- Point) nga vetë nxënësit ku ata mund të shfaqin punimet e tyre.

Për shembull:

- “Unë do të përdor të dhëna për të më ndihmuar të vendos nëse një faqe interneti është e dobishme apo jo.
- “Unë gjithmonë do ta kufizoj kërkimin tim kur të përdor motorët e kërkimit derisa të sigurohem që kam marrë rezultatet për të cilat kam nevojë.”

Si dhe ku mund të raportojmë rastet e abuzimit dhe shfrytëzimit online?



Platforma Kombëtare e Internetit të Sigurt në Shqipëri

<https://www.isigurt.al/>

Platforma Kombëtare e Informacionit për Sigurinë e Fëmijëve Online është një platformë e madhe online, e cila shërben si një burim unik informacioni në lidhje me internetin e sigurt për fëmijët. Kjo platformë ka prioritete të saj çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet e fëmijëve online, siç janë shkarkimi i materialeve, postimi, bisedat në 'chat', publikimi i të dhënave personale, cyberbulling, pornografinë online, përmbajtjet e papërshtatshme etj.

Ka një seksion për raportimin e abuzimit dhe përmbajtjeve të papërshtatshme. Ky seksion do të jetë me standardet më të larta profesionale dhe të besueshme për publikun për të lejuar raportimin anonim dhe konfidencial të përmbajtjes së papërshtatshme dhe të paligjshme të materialeve dhe aktiviteteve të hasura në internet. Seksioni RAPORTO do të ndihmojë fëmijët nga abuzimi online duke marrë dhe analizuar ankesa nga fëmijët, prindërit, mësuesit, profesionistët që punojnë me/për fëmijët apo çdo person tjetër i interesuar për të raportuar abuzimet online. Te gjitha raportimet do të referohen pranë agjencive përkatëse të zbatimit të ligjit dhe institucionet e tjera që ofrojnë shërbime për çështjet e abuzimit online.

Kjo platformë është e aksesueshme online në çdo moment dhe nga çdo vend, Ju mund të raportoni rastin tuaj, mund të gjeni informacione rreth çështjes së sigurisë kibernetike, por edhe të informoheni me të rejat e fundit të kësaj fushe. Kjo platformë është falas dhe ka si qëllim t'i vijë në ndihmë secilit rast të raportuar.



Si dhe ku mund të raportojmë rastet e abuzimit dhe shfrytëzimit online?



ALO 116-Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë

<https://alo116.al/>

ALO 116 - Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë është një shërbim pa pagesë për fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri, në 24 orë në çdo ditë të javës. Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijë është një instrument që ka për qëllim të këshillojë fëmijët përmes telefonit dhe të referojë nevojat e tyre në institucionet përkatëse.

Qëllimi kryesor i ALO 116 është mbrojtja e të drejtave të fëmijëve kur ata ndodhen në situatë rreziku dhe të sigurojë një qasje të përshtatshme që të gjithë fëmijëve t'u garantohen më shumë shërbime në kuadër të një sistemi mbrojtës efektiv dhe parandalues. Ky shërbim komunikon me fëmijët nëpërmjet numrave: 116-111 – Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijë dhe ALO 116-000 – Linja Kombëtare për Fëmijët e Humbur. ALO 116- Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë është një shërbim për fëmijët i cili ofron: këshillim psikologjik, informacion, referim në shërbimet përkatëse sipas specifikës së rastit.

Që nga viti 2009 ALO 116 e ka konsideruar internetin e sigurt si një çështje shumë të rëndësishme për mirëqënien e fëmijëve. Misioni kryesor i ALO 116 në lidhje me internetin e sigurt është të aftësojë fëmijët dhe të rinjtë që të përdorin internetin dhe komunikimin teknologjik pozitivisht dhe në mënyrë të sigurt. Gjithashtu, ALO 116 është e fokusuar në ndërtimin e mekanizmave dhe platformave që mbrojnë fëmijët online.



Veprimtari "Ku duhet të raportoj"



Qëllimi: Bashkëmoshatarët do të mësojnë se ku duhet të drejtohen për ndihmë dhe këshilla në rast rreziku në internet



Kohëzgjatja: 45 minuta



Nr.i pjesëmarrësve: 25-30 persona



Materialet: Letër dhe lapsa, skenarët të shkruar, të cilat ndodhen në fund të manualit (Moduli 4 - Veprimtaria 2), USB, Power Point.



Përgatitja:

Përgatisni skenarët për shembull: 'Një miku juaj poston diçka në Facebook, VEPRIMTARIA NR 2: "Ku të raportoj" Qëllimi: Kohëzgjatja: Nr.i pjesëmarrësve: Materialet: Përgatitja e cila ju mërzit', 'Shikon diçka në rrjetet sociale, e cila tregon që shoku/shoqja jote është duke u talluar, kërcënuar', 'Ke postuar një foto në rrjetet sociale të cilën nuk duhet ta postojë', 'Ke takuar një të panjohur në internet i cili të kërkon që ta takosh personalisht', 'Ke takuar një të panjohur në internet i cili të kërkon t'i dërgosh foto personale ku ti je e/i zhveshur', 'Je pjesë e një grupi në Whats up dhe një shok/shoqe dërgon një foto tallëse të një shoku të klasës'. 'Miku që ke njohur në internet të bën dhuratë një telefon celular'. Mund të shkruani të njëjtin skenar 3 herë dhe t'a shpërndani tek tre pjesëmarrës.



Përgatisni 6 flipcharte/ ose 6 kolona në dërrasë të zezë me fjalët: Miq, Prindër, Mësues, Psikologu i shkollës, Polici, Rrjetet sociale ose këto fjalë shkruajini në dërrasën e zezë. Raporto! Mësuesi/ psikologu i shkollës Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në Bashki Prindërit ALO 116 111 www.alo116.al/interneti-i-sigurte-raporto-online Skenarët e përgatitur shpërndaji tek disa pjesëmarrës, secili prej tyre do të ngrihet, do ta lexojë skenarin dhe do të thotë se ku do të drejtohet për ndihmë. Përgjigjen e tij do ta japë ose në dërrasën e zezë duke shkruar skenarin ose duke e ngjitur fletën ku është shkruar skenari tek flipchart ku mendon se do të marrë ndihmën që po kërkon nisur nga shkalla e rrezikut që paraqet situata

Prindërit

Alo 116 111

Policia
112 dhe 129

Punonjësi i
mbrojtjes së
fëmijës në
bashki

Mësuesi/
psikologu i
shkollës

Informacion teknik në lidhje me privatësinë e llogarive në rrjetet sociale

Kontrollo privatësinë e postimeve në rrjetet sociale sipas fotove të mëposhtme.



FACEBOOK

Kush mund të shikojë atë që unë hedh në faqen time të Facebookut?

<ul style="list-style-type: none">GeneralSecurityPrivacyTimeline and TaggingBlockingNotificationsMobileFollowersAppsAdsPaymentsSupport InboxVideos	<h4>Privacy Settings and Tools</h4> <table><tr><td>Who can see my stuff?</td><td>Who can see your future posts?</td><td>Friends</td><td>Edit</td></tr><tr><td></td><td>Review all your posts and things you're tagged in</td><td></td><td>Use Activity Log</td></tr><tr><td></td><td>Limit the audience for posts you've shared with friends of friends or Public?</td><td></td><td>Limit Past Posts</td></tr><tr><td>Who can contact me?</td><td>Who can send you friend requests?</td><td>Everyone</td><td>Edit</td></tr><tr><td></td><td>Whose messages do I want filtered into my Inbox?</td><td>Basic Filtering</td><td>Edit</td></tr><tr><td>Who can look me up?</td><td>Who can look you up using the email address you provided?</td><td>Friends of Friends</td><td>Edit</td></tr><tr><td></td><td>Who can look you up using the phone number you provided?</td><td>Friends of Friends</td><td>Edit</td></tr><tr><td></td><td>Do you want other search engines to link to your timeline?</td><td>No</td><td>Edit</td></tr></table>	Who can see my stuff?	Who can see your future posts?	Friends	Edit		Review all your posts and things you're tagged in		Use Activity Log		Limit the audience for posts you've shared with friends of friends or Public?		Limit Past Posts	Who can contact me?	Who can send you friend requests?	Everyone	Edit		Whose messages do I want filtered into my Inbox?	Basic Filtering	Edit	Who can look me up?	Who can look you up using the email address you provided?	Friends of Friends	Edit		Who can look you up using the phone number you provided?	Friends of Friends	Edit		Do you want other search engines to link to your timeline?	No	Edit
Who can see my stuff?	Who can see your future posts?	Friends	Edit																														
	Review all your posts and things you're tagged in		Use Activity Log																														
	Limit the audience for posts you've shared with friends of friends or Public?		Limit Past Posts																														
Who can contact me?	Who can send you friend requests?	Everyone	Edit																														
	Whose messages do I want filtered into my Inbox?	Basic Filtering	Edit																														
Who can look me up?	Who can look you up using the email address you provided?	Friends of Friends	Edit																														
	Who can look you up using the phone number you provided?	Friends of Friends	Edit																														
	Do you want other search engines to link to your timeline?	No	Edit																														

Në seksionin Settings/Timeline mund të vendosni se kush do mundet të postojë në faqen e Facebookut tuaj. Nëse vendosni ONLY Me, atëherë askush përveç jush nuk do mundet të postojë në faqe. Kjo pengon persona të paautorizuar të postojnë materiale të padëshiruara në faqe.

Timeline and Tagging Settings

Who can add things to my timeline?	Who can post on your timeline?	Only Me	Edit
	Review posts friends tag you in before they appear on your timeline?	Off	Edit
Who can see things on my timeline?	Review what other people see on your timeline		View As
	Who can see posts you've been tagged in on your timeline?	Only Me	Edit
	Who can see what others post on your timeline?	Only Me	Edit
How can I manage tags people add and tagging suggestions?	Review tags people add to your own posts before the tags appear on Facebook?	Off	Edit
	When you're tagged in a post, who do you want to add to the audience if they aren't already in it?	Only Me	Edit
	Who sees tag suggestions when photos that look like you are uploaded?	No One	Edit


Informacion teknik në lidhje me privatësinë e llogarive në rrjetet sociale



SNAPCHAT


Për të ndryshuar privatësinë e postimeve në Snapchat veproni si më poshtë:

1. Së pari logohuni në Snapchat






2. Shkoni te kamera.

Ky veprim do të hapë profilin tuaj



3. Shkoni te settings, duke klikuar butonin në cepin djathtas lart, siç tregohet në kuadratin jeshil .

4. Do t'ju shfaqet pamja e mëposhtme: Klikoni mbi Contact Me. Në foton e mësipërme është aktivizuar opsioni që mund t'ju kontaktojnë të gjithë (Everyone), Ndryshoni këtë opsion për t'ju kontaktuar vetëm miqtë, sipas fotos më poshtë:



5. Shtypni butonin < për t'u kthyer te menu kryesore.

6. Klikoni "View My Story", për të kontrolluar se kush mund të shohë story-t që postoni. Automatikisht është aktivizuar opsioni "Everyone" – të gjithë mund t'i shohin story-t tuaja. Ndryshojeni këtë opsion nga "Everyone" në "My friends"

